



Република Северна Македонија

Министерство за одбрана

**RAPORT MBI SHKALLËN E ZBATIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT 2021-2024 PËR PERIUDHËN 1 KORRIK -
31 DHJETOR 2024**

Në përputhje me Politikën aktive të transparencës, Ministria e Mbrojtjes rregullisht dhe çdo gjashtë muaj përgatit dhe publikon një raport për shkallën e realizimit të aktiviteteve të parashikuara nga Plani i integritetit 2021-2024 dhe planet vjetore të aktiviteteve që dalin prej tij.

Raportet gjashtëmujore përgatiten në mënyrë të standardizuar, në një matricë të dizajnuar posaçërisht, e cila është pjesë e Planit.

Raporti i gjashtë për shkallën e zbatimit të Planit të Integritetit i referohet periudhës 01.07 - 31.12.2024.

Pas zbatimit të Planit të Integritetit 2021-2024, në vitin 2025 do të bëhet një vlerësim i progresit të arritur me zbatimin e Planit.

Organi përgjegjës për monitorimin e zbatimit është Grupi i punës për ndërtimin e integritetit në Ministrinë e Mbrojtjes.

Për periudhën 01.07-31.12.2024, sipas Planit të Integritetit 2021-2024 dhe Planit të Veprimtarive për vitin 2024, janë realizuar katër aktivitete ose të ndara sipas fushave: Burimet Njerëzore – një aktivitet, Prokurimet Publike – një aktivitet dhe Kontrolli i Brendshëm – dy aktivitete. Ato zbatohen me mbështetjen e ekspertëve nga Qendra për integritet në sektorin e mbrojtjes të Mbretërisë së Norvegjisë – CIDS.

Sipas informacionit të dhënë nga CIDS lidhur me burimet e kufizuara që kishin vitin e kaluar, pra mundësitë e kufizuara të udhëtimit për ekspertët e tyre, një pjesë e trajnimeve dhe aktiviteteve nga Plani i Veprimit 2024, të cilat do të zbatoheshin në vitin 2024, do të zbatohen gjatë vitit 2025.

Koordinator për zbatimin e aktiviteteve të Planit të integritetit
të Ministrisë së Mbrojtjes dhe person përgjegjës për
bashkëpunim me Qendrën Norvegjeze për integritet në
sektorin e mbrojtjes (CIDS)

Nikica Jovanovska

X. Fusha I: - Menaxhimi i burimeve njerëzore

Pikë referimi: - Përmirësimi i efikasitetit të sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore

Aktiviteti	Rezultatet e pritshme	Zbatimi i aktivitetit ("Po" dhe kur ato zbatohen në vazhdim, "Jo")	Rezultatet e arritura	Numri i njerëzve të përfshirë	Shënime shtesë
Përgatitja e rregullores për zbatimin e planifikimit në menaxhimin e burimeve njerëzore.	Rregullorja e përgatitur për planifikimin e burimeve njerëzore	Po	Përmirësimi i sistemit të planifikimit në fushën e burimeve njerëzore		Aktiviteti 2.3 i Planit të Veprimit për vitin 2024 Është përgatitur metodologjia për realizimin e aktivitetit. E njëjta është pjesë e Planit të Veprimit për vitin 2025 dhe do të zbatohet plotësisht gjatë vitit 2025.

Fusha: IV - Prokurim Publik

Pikë referimi: - Përmirësimi i strukturës organizative dhe kapaciteteve institucionale për të garantuar integritet dhe transparencë në prokurimin publik

Aktiviteti	Rezultatet e pritshme	Zbatimi i aktivitetit ("Po" dhe kur ato zbatohen në vazhdim, "Jo")	Rezultatet e arritura	Numri i njerëzve të përfshirë	Shënime shtesë
5. Trajnim Menaxhimi i riskut dhe regjistri i riskut në prokurimin publik dhe atë të mbrojtjes	Trajnime të realizuara onllajn në fushën e menaxhimit të riskut dhe regjistrin të riskut në prokurimin publik dhe atë të mbrojtjes	Po	Përmirësimi i aftësive dhe përmirësimi i zbatimit praktik të rrezeve në prokurimin publik dhe atë të mbrojtjes	23	Aktiviteti 3.2 i Planit të Veprimit për vitin 2024 Aktiviteti realizohet me mbështetjen e ekspertëve nga Qendra për integritet në sektorin e mbrojtjes të Mbretërisë së Norvegjisë - CIDS

Fusha: VI - Kontrolli i brendshëm

Pikë referimi: - Rritja e rolit të auditimit të brendshëm dhe inspektoratit në ndërtimin e integritetit

Aktiviteti	Rezultatet e pritshme	Zbatimi i aktivitetit ("Po" dhe kur ato zbatohen në vazhdim, "Jo")	Rezultatet e arritura	Numri i njerëzve të përfshirë	Shënime shtesë
Analizë e efekteve të zbatimit të Kodit të Etikës për punonjësit e Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Armatës	Avancimi i sistemit të qeverisjes së mirë në mbrojtje dhe promovimi dhe mbrojtja e integritetit dhe profesionalizmit	Jo	Janë identifikuar mangësi dhe nevoja për avansimin në lidhje me qeverisjen e mirë në sektorin e mbrojtjes	/	Aktiviteti 38 i Planit të Veprimit për vitin 2024 Aktiviteti do të realizohet gjatë vitit 2025 për shkak të ndryshimeve dhe shtesave në Kodin e Etikës

<p>Analiza e boshllëkut të qeverisjes së mirë</p>	<p>Identifikimi i mangësive dhe nevojave në drejtim të qeverisjes së mirë në sektorin e mbrojtjes.</p>	<p>Po</p>	<p>Avancimi i sistemit të qeverisjes së mirë në sektorin e mbrojtjes duke marrë parasysh nevojën për të promovuar dhe mbrojtur më tej integritetin dhe profesionalizmin.</p>	<p>/</p>	<p>Aktiviteti 1.7 i Planit të Veprimit për vitin 2024</p>
<p>Rishikimi i sistemit të përhershëm dhe praktikave në lidhje me “vendimmarrjen” brenda MM-së dhe Armatës</p>	<p>Rishikimi i sistemit të përhershëm të vendimmarrjes në MM dhe Armatë</p>	<p>Po</p>	<p>Krahasimi dhe kuptimi i praktikave më të mira përmes diskutimeve me autoritetet në MM</p>		<p>Aktiviteti 37 i Planit të Integritetit 2021-2024</p>